

PSE I'A VLEN ÇË JU TË VOTONI NË 2021?

A e dini se, mund të jeni në gjendje të votoni në zgjedhjet komunale të Turkut edhe nëse nuk jeni shtetas Finlandez? Kjo do të mund të realizohet nëse jeni të paktën 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve, jeni regjistruar në Turku, ose jeni...

1. Shtetas i një vendi të BE-së, Norvegjisë ose Islandës OSE
2. Ju jeni shtetas i një vendi tjetër DHE keni jetuar në Finlandë të paktën për dy vjet.

Zgjedhjet komunale janë zgjedhje të rëndësishme. Qyteti i Turkut është përgjegjës për shumë gjëra të cilat prekin të gjithë ne. Këto përfshijnë, për shembull, shërbime shëndetësore, shkollat, kopshtet e fëmijëve, transportin publik, rrjetin rrugor, bibliotekat, parqet dhe shumë gjëra të tjera.

Asambleja e qytetit vendos se si duket dhe si ndihet Turku. I merr të gjitha vendimet e rëndësishme në Turku. Shembuj të vendimeve të tilla janë si për shembull.....

- Ku do të ndërtohen shkolla të reja?
- A duhet të jetë falas kujdesi shëndetësor?
- Sa e madhe duhet të jetë taksa komunale?
- Si të përmirësojmë transportin publik?
- ... dhe një numër i madh vendimesh të tjera.

Asambleja e qytetit zgjidhet në mënyrë demokratike në zgjedhjet komunale çdo katër vjet. Zgjedhjet e ardhshme komunale janë me: 13.6.2021

Që të mund të votoni, duhet të merrni një letër me postë (në gjuhën finlandeze "njoftimi për të drejtën e votës") rreth një muaj para zgjedhjeve. Informacione më të hollësishme (vetëm anglisht) janë në dispozicion në këtë faqe:

<https://vaalit.fi/en/right-to-vote-and-compilation-of-the-voting-register>

PSE I'A VLEN ÇË JU TË VOTONI TË GJELBËRIT?

Të Gjëlberit (Aleanca e Gjëlber) aktualisht është partia e dytë më e madhe në Turku. Në veçanti, ne mbështesim barazinë, natyrën, klimën, arsimimin, shërbimin shëndetësor dhe transparencën.

Temat tona kryesore në Turku janë:

- Qyteti duhet të mbrojë klimën. Kjo kërkon transport publik efikas si dhe mbështetje për çiklizëm dhe ecje.
- Qyteti duhet të mbrojë pasurit natyrore. Të gjithë duhet të kenë qasje të lehtë në natyrën e afërt.
- Qyteti duhet të projektohet në mënyrë efikase, por gjithashtu duhet të jetë i gjëlberuar dhe i bukur.
- Të gjithë duhet të kenë qasje të barabartë në arsimim me cilësi të lartë. Duhet të punësohen mësimdhënës të mjaftueshëm dhe shkollat duhet të financohen siç duhet.
- Turku duhet të jetë qyteti më i mirë studentor në Finlandë.
- Shërbimet shëndetësore dhe sociale duhet të jenë të disponueshme për të gjithë, përfshirë emigrantët dhe azilkërkuesit pa dokumenta.
- Qyteti duhet të mbështesë njerëzit që kanë më së shumti nevojë për ndihmë: të moshuarit, fëmijët, njerëzit me probleme të shëndetit mendor ose që vuajn nga varësia, emigrantë të cilët ende nuk kanë njohuri të mira të gjuhës finlandeze.
- Jeta e mirë përfshin gjithashtu kulturën dhe sportin dhe këto duhet të mbështeten.
- Ekonomia do të jetë mirë nëse njerëzit janë mirë. Problemet duhet të zgjidhen shpejt përpara se ato të bëhen probleme të kushtueshme dhe të vështira.
- Duhet të shtohet transparenca e qytetit në mënyrë që të jetë e qartë se si shpenzohen paratë e taksave.
- Qyteti duhet të kërkojë dhe mbështesë bizneset, të cilat mund të sigurojnë punë për të gjithë banorët.